



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4171/1 Prot.

Tiranë, më 2.7. 2025

URDHËR

NR. 296, DATË 2.7.2025

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR
NË “INFERMIERI E PËRGJITHSHME” NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”,
VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme” në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht me kodet 63BA0913S dhe 63BA0913A, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme”, në Fakultetin e Shëndetit, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, referuar nivelit 6, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme”, në Fakultetin e Shëndetit, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ



Konceptoi: M. Kamberi
A. Manja
Miratuan: B. Biçoku
V. Koçi
Konfirmuan: J. Çollaku
E. Tola
Data e shkresës
tek SP: ____06.2025
Nr. i kopjeve të
shkresës: 5